

VENDIM
Nr. 343, datë 19.4.2017

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.614, DATË 7.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND BANESE, ME VENDIME TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE, NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE DHE TË SHTETIT, KU JANË SISTEMUAR ME STREHIM BANORË TË PAJISUR ME AUTORIZIM NGA ORGANET KOMPETENTE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 39/1, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 614, datë 7.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Brenda 1 (një) viti, nga miratimi i këtij vendimi, bashkia njofton qytetarët me mjete të njoftimit publik, ku përfshihen afishimi i njoftimit në mjediset e bashkisë, në vende publike ose botimi i njoftimit në gazetën e pushtetit vendor, njoftimi me postë, postë e thjeshtë ose e porositur, dorëzimi personalisht i njoftimit, nëpërmjet të tretit apo postës, për të paraqitur kërkesat e tyre për privatizimin e banesave, objekteve të kthyer në fond banese dhe për procedurat që duhet të ndjekin."

2. Në pikën 4, fjalët "...brenda 1 (një) viti, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi..." zëvendësohen me "...brenda 1 (një) viti nga njoftimi publik i bashkisë..."

3. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Pas kalimit të së drejtës së pronësisë në favor të njësive të qeverisjes vendore, kjo e fundit nis procedurat për regjistrimin e pronës në emër të saj, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.33, datë 21.3.2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar. Pas regjistrimit në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bashkia bën njoftimin me mjete publike për fillimin e procedurës së privatizimit."

4. Në pikën 10, fjalët "...për pikat 4 e 16...", zëvendësohen me "...për pikat 4 e 15..."

5. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje :

"11/1. Në rastet kur banesës apo objektit që kthehet në fond banese nuk mund t'i përcaktohet data e ndërtimit, për shkak të mungesës së dokumentacionit, koeficienti i amortizimit të llogaritet me datën e lëshimit të autorizimit të dhënë familjes për strehim në këtë banesë apo objekt."

6. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda 1(një) muaji, nga dorëzimi i dokumentacionit nga qytetarët, shqyrton dosjen e privatizimit dhe vendos pranimin ose refuzimin e saj."

7. Në pikën 17, fjalët "Nëse familja..." zëvendësohen me "Nëse subjektet, sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 3, të këtij vendimi..."

8. Pas pikës 23 shtohen pikat 23/1 dhe 23/2, me këtë përmbajtje:

"23/1. Nëse subjektet përfituese nuk respektojnë afatet e përcaktuara në pikat 4 e 15, për paraqitjen e kërkesës për privatizim dhe lidhjen e kontratës së privatizimit me bashkinë, banesa ose objekti i kthyer në fond banese kalon në banesë sociale me qira, me vendim të këshillit bashkiak. Bashkia duhet të lidhë kontratat e qirasë me qytetarët, banorë në këto objekte.

Nëse familja nuk pranon të qëndrojë më gjatë, në cilësinë e qiramarrësit, në banesë sociale, atëherë

bashkia ndjek procedurat e përcaktuara për programin e banesave sociale me qira, për qëllime të strehimit social për familjet në nevojë.

23/2. Për përcaktimin e masës së qirasë, bashkia vepron sikurse për përcaktimin e qirasë në banesat sociale me qira, sipas pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar. Kontratat e qirave rinovohen çdo vit pranë bashkive përkatëse.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi